



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



KUVENDI I KOMUNËS  
Skupština Opština  
Municipal Assembly



## KONTRATA PËR FURNIZIME

**KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe "AOME" shpk me NRB 71162702 nga Prishtina (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga Hasim Makolli me autorizim LRP, Nr. rend. 6168/2017, (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

Furnizim me pelet per nxemje qendrore, me numër identifikues 652-18-7462-1-3-6

Neni 1            Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë *Furnizim me pelet per nxemje qendrore per QKMF-në*.
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me *23.10.2018* dhe përfundon me *01.11.2018*.
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se dy (2) ditë nga data e marrjes së urdhëreses.
- 1.4 Vend i do të jetë QKMF -Kaçanik
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2            Ligji i aplikueshëm

- 2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkaksose në Prishtinë.

Neni 3            Çmimi

- 3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4,860.00€; (Katermijëtetqindëgjashtëdhjetëeuro dhe 00/100€)**.
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vëtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4            Pagesat

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

#### 4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën e detyrimeve pas pranimit të furnizimeve nga ana e personit të autorizuar, dhe raportit të komisionit per pranimin e Furnizimive.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj se cilën shumën e detyrimeve pas pranimit të seçesë derguese]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatumin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet te plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *furnizimeve*

#### Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorezoj ndonjë ose të gjitha malitai] [të realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet] [ta kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve* [produktive] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshterinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshteria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktajoj pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### Neni 11 Ndërpërja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dëkujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykate për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupcion, përfshirje në ndonje organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

**Neni 12****Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguaje Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimiti nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *specifiko gjykatën kompetencë* në pajtim me ligjin e Kosovës.

**Neni 14****Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jep Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen *[Shqip]*<sup>2</sup> në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

**Për Operatorin Ekonomik**

**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	Hasim Maloku	Emri:	Shefqet Koxha
Pozita:	I autorizuar	Pozita:	Menaxher i Prokurimit
Nënshtakrimi:	<i>[Handwritten signature]</i>	Nënshtakrimi:	<i>[Handwritten signature]</i>
Dati:	<i>[Handwritten date]</i>	Dati:	<i>[Handwritten date]</i>
Vudu:		Vudu:	

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tj.

Përshtkimi i çmimeve

Nr. Rezid.	Përshtkimi	Nj.M	Sasia	Çmimi	Totali
1	Furnizim me pelet për nxemje qendore Pelet A-1 përbërja nga qami paketimet 15 kg.	ton	20	243	4860
2					
3					

TOTALI

€

